




REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIJA KUNDER KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	Nr. Prot.
Dep.	Br. Prot.
Dep.	Prot No.
Nr. i faq. Broj stranica Nr. pages	01-1019/15
03	
Data Datum Date	07.04.2015
PRATITINË	



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosova

**AGJENCIJA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit si dhe nenin 24 paragrafi 11 dhe 12 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korruptionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korruptionit me datë 02.04.2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

I, Mbylljet rasti me Nr. AKK-03-02-501-15 për z. *Blerand Stavileci –Këshilltar në Kuvendin Komunal të Prishtinës, për shkak se nuk ka pasur prova të mjaftueshme që argumentojnë gjendjen e konfliktit faktik të interesit në ushtrimin e funksionit publik, me rastin e pjesëmarrjes për votim në Kuvendin Komunal të Prishtinës, për zgjedhjen e Këshillit të Aksionarëve për Ndërmarrjet publike komunale.*

Zyrtari i lartë, z. *Blerand Stavileci, është i obliguar që në rast të paraqitjes eventuale të ndonjë situate me konflikt interesit, të bëjë deklarimin "rast për rast" të interesave private (konform neni 13, paragrafi 1,2,3).*

II. Rasti mund të rihaqet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesit në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-02-501-15, për Zyrtarin e lartë, z. Blerand Stavileci–Këshilltar Komunal në Komunën e Prishtinës, dhe njëkohësisht Ministër në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik në Qeverinë e Kosovës, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligi Nr. 04/L-051).

Në rastin me numër protokolli i AKK-03-02-501-15, të dyshuar për konflikt interesit në ushtrimin e funksionit publik, pas procedurës së shqyrimit, kemi konstatuar se nuk ka pasur prova të mjaftueshme që argumentojnë gjendjen e konfliktit të interesit me rastin e pjesëmarrjes për votim në Kuvendin Komunal të Prishtinës, për zgjedhjen e Këshillit të Aksionarëve për Ndërmarrjet publike komunale.

Zyrtari i lartë, z. Stavileci, është Këshilltar komunal në Komunën e Prishtinës, e njëkohësisht ushtron edhe postin e Ministrit në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik.

Ligi për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, nuk ka dispozita të cilat e ndalojnë shprehimisht, por as që e cilësojnë si të papajtueshëm ushtrimin e këtyre dy funksioneve publike.

Ushtrimi i këtyre dy funksioneve mund të sjell eventualisht ndonjë situatë të konfliktit të interesit “rast për rast”, por në bazë të Ligjit për Parandalimin e konfliktit të interesit, nen 13, paragrafi 1, në këto situata zyrtari është i obliguar që të bëjë deklarimin paraprak, “rast për rast” të interesave të tij private.

Kjo pra është e rregulluar me nenin 13 paragrafi 1, 2, 3, në të cilin shprehimisht thuhet:

1. Çdo zyrtar i lartë gjatë ushtrimit të funksionit të tij publike, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vet deklarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij private lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhen shkak për lindjen e një konflikti të interesit.

2. Deklarimi rast për rast i interesave private bëhet çdo herë nga zyrtari i lartë, kur kjo kërkohet nga eprori ose nga institucioni mbikëqyrës. Deklarimi si rregull duhet kërkuar dhe bërë paraprakisht. Kur kjo nuk është e mundur ose kur nuk ka ndodhur, deklarimi duhet të kërkohet të bëhet sa me shpejt që të jetë e mundur.

3. Vetë deklarimi si rregull bëhet me shkrim, kur zyrtari i lartë përfshihet në një vendimmarrje për ndonjë çështje të caktuar.

Po ashtu, Ligi Nr.03/L-040, Për vetëqeverisjen lokale, në katër paragrafë të nenit 38 e rregullon çështjen e konfliktit të interesit si vijon :

38.1 Anëtari i kuvendit të komunës apo anëtari i komitetit nuk mund të jetë pjesëmarrës në marjen e vendimeve dhe në procedurat administrative që kanë të bëjnë me cilëndo çështje në të cilën ai ose ajo, apo ndonjë anëtar i afërt i familjes së tij apo saj, ka interes personal apo material.

38.2 Çdo anëtar duhet t'i shfaqë të gjitha konfliktet e interesit që lindin në çdonjëren prej mbledhjeve në të cilën është prezent. Çdo këshilltar mund të ofrojë informacione për interesat e anëtarit tjetër.

38.3 Para mbledhjes së parë të kuvendit të komunës, anëtarët e kuvendit duhet t'i regjistrojnë deklaratat e plota dhe të hapura rreth interesave të tyre financiare në një regjistër publik të cilin e mbanë shefi i administratës dhe përsonelit. Anëtarët duhet të shënojnë çdo ndërrim të gjendjes së tyre financiare posa ato të ndodhin.

38.4 Statuti dhe Rregullorja e punës përcaktojnë masat që masat për përjashtimin e anëtarëve nga procesi i marjes së vendimeve dhe nga procedurat administrative, aty ku kanë konflikt të interesit.

Nuk qendron pretendimi se Ministri i Zhvillimit Ekonomik duke qenë themelues i Njësisë për Politikat dhe Monitorimin e Ndërrmarrjeve Publike ka raport menaxhues edhe me Ndërrmarrjet publike komunale.

Në Ligjin për Ndërrmarrjet publike (Nr.03/L-087) në nenin 37, paragrafi 1, shprehimisht thuhet:

“Njësia për Politikat dhe Monitorimin e NP-ve do të themelohet nga Ministri në kuadër të Ministrisë me qëllim të mbështetjes së Ministrit dhe Qeverisë në ushtrimin e përgjegjësive për NP-të, të cilat u janë dhënë atyre me këtë ligj. Udhëheqësi i Njësisë për NP do të emrohet nga Ministri”.

Ndërsa, Neni 37, paragrafi 2, nënparagrafi a), tregon qartë se cilat NP janë në kompetencë të Ministrit, duke përshkruar kompetencën:

37.2. Njësia për NP gjithashtu do të :

a) përgatisë dhe dorëzoj Ministrin, për transmetim në Qeveri, analiza dhe rekomandime lidhur me çështjet e NP Qendrore që janë në kompetencën e Ministrit dhe/ose Qeverisë.

Fakti se Ndërrmarjet publike komunale nuk hyjnë në kompetecën mbikqyrese të Ministrit të Zhvillimit Ekonomik e dëshmojnë edhe dispozitat e Nenit 28 të Ligjit për NP, kur flitet për Vlerësimin e Efektshmërisë së Bordit të Drejtoreve.

Paragrafi 2 i këtij nenit shprehimisht thotë: *“Bordi duhet të sigurojë që rezultati i vlerësimit të realizuar sipas paragrafit 1 të këtij nenit të përmblidhen në një raport me shkrim i cili i dërgohet (1) Ministrin dhe Qeverisë së Kosovës për NP Qendrore, dhe (2) Anëtarëve të Komisionit(eve) Komunale të Aksionarëve për NP Lokale”.*

Nga kjo del se; sa i përket Vlerësimit të efektshmërisë së Bordit të Drejtoreve, roli i Ministrit të MZHE-së për Ndërrmarjet publike qendrore, për nga kompetenca është ekuivalente me rolin e Komisionit(eve) komunale të Aksionarëve për NP lokale.

Sipas Ligjit për Ndryshimin e ligjit për ndërrmarjet publike (Nr. 04/L-111, Neni 23) në listën 1 janë të përfshira Ndërrmarjet Publike Qendrore, të cilat janë:

1. Korporata Elektroenergjetike e Kosovës sh.A (KEK);
2. Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim te Energjisë(KKDFE);
3. Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut, sh.A (KOSTT);
4. Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës sh.A (PTK);
5. Hekurudhat e Kosovës-TrainKos sh.A;
6. Hekurudhat e Kosovës-InfraKos sh.A;
7. Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës-Kontrolli Ajror ”Adem Jashari” sh.A;
8. Kompania për Menaxhimin e Deponive sh.A;
9. NPH Iber Lepenc Sh.A.

Po ashtu, në po këtë nen, janë edhe Ndërrmarjet publike komunale, të Komunës së Prishtinës;

1. Ngrohtorja e Qytetit Termokos sh.a, Prishtinë, Prishtina 100%;
2. Ndërmarrja Publike Banesore, Prishtinë , Prishtina 100%;
3. Kompania Rajonale e Mbeturinave Pastrimi sh.A, Prishtinë;

4. Hortikultura sh.a -Prishtinë, Prishtina 100%;
5. Sport-Marketing sh.a –Prishtinë, Prishtina 100%;
6. NPK Trafiku Urban sh.a -Prishtinë, Prishtina 100%;
7. Stacioni i Autobusëve Prishtinë, Prishtina 100%.

Ushtrimi i funksionit të Këshilltarit komunal si dhe pjesëmarrja në procesin e zgjedhjes së Aksionarëve të NP komunale të Prishtinës dhe funksionit Ministër në Qeverinë e Kosovës, as te ligji për Parandalimin e konfliktit të interest (Nr.04/L-051), por as te ligjet tjera të përafërtë që rregullojnë këto çështje, kur nuk ka konflikt interesit, nuk ka ndalesë.

Prandaj, meqenëse në drejtësi vlen maksima se “*ajo që nuk është e ndaluar, nënkuptohet se është e lejuar*”, rrjedhimisht do të thotë se ushtrimi i këtyre dy funksioneve aktualisht nuk ndalohet me ligj.

Ndërsa shikuar në aspektin logjik, del pothuajse e domosdoshme që edhe për këto dy funksione të ketë kufizim apo ndalesë për shkak se ekziston konflikt në dukje i interesit (por, jo konflikt faktik) dhe për shkak të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit publik.

Por, përderisa kjo nuk është e rregulluar shprehimisht me ligj, Agjencia Kundër Korrupsionit është e obliguar që të respektoj dhe të zbatoj dispozitat bazë të legjislacionit pozitiv.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./zpj. (zyrtari ndihmës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

/ Hasan Preteni

